



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	25.09.2012
REFERENC-Ë:	AKK-DPK-
PËR/ZA/TO:	z. Shaip Surdulli Kryetar i Komunës së Kamenicës
CC:	z. Enver Mavriqi Kryesuesi i Kuvendit të Kamenicës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	z. Hasan Preteni Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Ankandin Publik "Dhënia me Qira e Pronës së Paluajtshme Komunale-Hapësira e Tregut të Gjellbër"

Të nderuar,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 pika 12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenin 19 paragrafi 1 pika 6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me Ankandin Publik ("Dhënia me Qira e Pronës së Paluajtshme Komunale-Hapësira e Tregut të Gjellbër" me nr. prokurimi) ofron këtë:

O P I N I O N

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues, (në tekstin e mëtejme AK), që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Ankandin Publik "Dhënia me Qira e Pronës së Paluajtshme Komunale-Hapësira e Tregut të Gjelbër", në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik dhe Ligjit nr.03/L-226, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

A r s y e t i m

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik ka për detyrë të nxjerr rregulla për organizimin dhe udhëheqjen e heqjes/ shitjes së aseteve nga ana e Autoritetit Kontraktues, heqja / shitja e aseteve duhet të udhëhiqet duke aplikuar procedurat e parapara në këtë rregullore dhe e njëjta duhet të menaxhohet nga Departamenti Prokurimit të Autoritetit Kontraktues. Autoriteti Kontraktues me këtë rast ka dështuar të përmbahet kësaj rregullore ngase procedurat e parapara për udhëheqje nga Departamenti Prokurimit i ka udhëhequr Komisioni për dhënie në shfrytëzim të pronës Komunale.

Komisioni për dhënie në shfrytëzim të pronës Komunale në Komunën e Kamenicës, si autoritet kontraktues, ka bërë publikimin e këtij ankandi në një gazetë zyrtare, mirëpo të njëjtin ankand nuk e ka publikuar edhe në faqen e internetit të KRPP-së ashtu siç kërkohet në bazë Rregullores për shitje / heqje të Aseteve të përgatitur nga KRPP-ja dhe të publikuar në faqen e internetit të KRPP-së.

Kompania "VIVA FRESH" ka parashtruar kërkesë për lejimin e shfrytëzimit të përkohshëm të hapësirës publike në tregun e gjelbër për hapjen e një qendër tregtare.

Kuvendi Komunal i Kamenicës më datë 31.07.2012, ka miratuar kërkesën dhe formoi komisionin për zbatimin e procedurave për dhënie me qira të pronës së paluajtshme Komunale.

Komisioni në bazë të vendimit 01-16-3412 të datës 13/08/2012, ka filluar punën më datë 14.08.2012 dhe konstaton :

Hapësira e tregut të gjelbër duke u bazuar në ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës nr.03/L-226 neni 5 pika 1,2 neni 7, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 të nenit 14 dhe 17 nënë c dhe k, Ligjit për procedurë administrative nr.02/L-28 neni 38, vendimit të Kuvendit Komunal nr. 01/3412 të datës 13.08.2012 dhe projektit ideor të ofruar nga zyra e Kadastrit mund të filloj procedurat për dhënien në shfrytëzim të pasurisë së lartcekur.

Komisioni në përbërje të plotë ka punuar dhe ka ofruar shënimet lidhur me procedurat dhe kriteret për shpalljen e ankandit publik të hapësirës së lartë cekur.

Kriteret për dhënie me qira të një pjese të hapësirës publike tregu i gjelbër në Kamenicë:



Qendër Tregtare, Vlera e investimeve, Numri punëtorëve (punësimi), Çmimi më i lartë për metër katrorë, Garancioni , Afati i shfrytëzimit të jetë 10 vite, Ankandi duhet të bëhet me oferta te mbyllura. Ndërsa ne aplikacionin e përgatitur nga Komisioni për shfrytëzim te pronës komunale ne piken nr: 8 Dokumentet e nevojshme për aplikim: janë te kërkuara të dërgohen nga aplikuesit edhe pse nuk janë te përfshira ne procesverbalin e datës 14.08.2012.

Komisioni për dhënie në shfrytëzim të pronës Komunale në Komunën e Kamenicës, nuk ka përdorur dosjen e tenderit e cila është përgatitur nga KRPP-ja për shitje të aseteve përmes ofertimit publik, por ka përdorur një aplikacion për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme gjë që është në kundërshtim me nenin 27 LPP-së 04/L-042.

Komisioni në përbërje të plotë (i njëjti) ka bere hapjen e ofertave më datë 28.08.2012, dhe njëherë ka ber vlerësimin e ofertave më datë 30.08.2012 gjë që është në kundërshtim me nenin 56 pika 4 Udhëzuesit Operativ Prokurimit Publik.

Procedura Vlerësimit:

O.E “ VIVA FRESH” – kishte dokumentacionin e pa kompletuar (Fletë aplikacioni jo i plotësuar ashtu si është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues (Sipërfaqja në m² e pa plotësuar, Shfrytëzimi hapësirës i pa plotësuar), Referenca për kompaninë ekzistuese nuk ka ofruar.

Personi Fizik “Besim Rexhepaj” Kapitali i garantuar për investime te pika 9 ne aplikacion është kërkuar Vlera e investimeve- Kapitali i garantuar (verifikimi buxhetor i kompanisë). Një kërkesë vlen vetëm për kompanitë e jo personat fizik te cilët marre pjese ne këtë ankand.

Personi Fizik “ Muhamet Morina” - kishte dokumentacionin e pa kompletuar (Biografia e kompanisë apo personit fizik që aplikon, Projekti Investues, Sigurimi i ofertës në vlerë prej 5000.00 €).

Komisioni i formuar nga Komuna Kamenicës më datë 31.07.2012 dhe protokolluar më datë 13.08.2012 në përbërje prej:

1. Besnik Rudhani , kryetar
2. Merita Agaj , anëtare
3. Agim Basha , anëtar
4. Shaban Canaj , anëtar
5. Ramush Ismajli , anëtar

A.K me rastin e përgatitjes së Aplikacionit në pikën 6 ka kërkuar çmimin për m² por nuk e ka përcaktuar se pagesa e qeras do të jetë (Mujore apo Vjetore) Me këtë veprim nuk është respektuar Rregullorja për ngarkesa, taksa, taksa dhe gjoba komunale.

Me datën 31.08.2012 Kuvendi i Komunës së Kamenicës ka nxjerrë Vendim për dhënien në shfrytëzim të patundshmërisë në pronësi komunale në kundërshtim me kriteret e ankandit publik të shpallur në shtyp me datën 17.08.2012

Me respekt!